

V E N D I M
Nr.315, datë 25.7.1997

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E KUVENDIT POPULLOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR MË VENDIMIN NR.206, DATË 2.7.1991,
PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.226, DATË 14.5.1992, NR.234, DATË
21.10.1992, NR.279, DATË 8.7.1996 DHE NR.280, DATË 16.7.1996**

Në mbështetje të nenit 18, paragrafi i dytë të ligjit nr 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesor kushtetuese"

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në Rregulloren e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 206, datë 2.7.1991, plotësuar e ndryshuar me vendimet nr. 226, datë 14.5.1992, nr.234, datë 21.10.1992, nr. 279, datë 8.7.1996 dhe nr. 280, datë 16.7.1996 bëhen këto shtesa e ndryshime:

I. Në nenin 8 në fund të paragrafit të parë të shtohet fjalia: "Pranë komisioneve të përherëshme, në përbërjen e tyre, funksionojnë edhe nënkomisione për probleme të veçanta".

Po në nenin 8, në fund të paragrafit të tretë të shtohen fjalët: "apo nënkomisione".

II. Neni 9 ndryshohet si vijon: "Në sesionin e parë të Legjislaturës zgjidhen komisionet e përherëshme dhe nënkomisionet me emërtimin dhe përbërjen si vijon:

1. Komisioni për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, me 13 anëtarë.

Në përbërje të këtij komisioni do të funksionojë:

Nënkomisioni i Pushtetit Lokal, me 7 anëtarë.

2. Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet, me 7 anëtarë.

3. Komisioni për Politikën e Jashtme, me 9 anëtarë.

4. Komisioni për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin, me 15 anëtarë.

Në përbërje të këtij komisioni do të funksionojnë dhe:

a) Nënkomisioni i Kontrollit Buxhetor, me 5 anëtarë.

b) Nënkomisioni i Reformës së Privatizimit, me 5 anëtarë.

5 Komisioni i Mbrojtjes, me 9 anëtarë.

6. Komisioni i Rendit e SHIK-ut, me 9 anëtarë.

6. Komisioni për Mjetet e Informimit Publik, me 9 anëtarë.

7. Komisioni i Punës dhe Problemeve Sociale, me 13 anëtarë.

Në përbërje të këtij komisioni do të funksionojnë dhe:

a) Nënkomisioni për Rininë dhe Gruan, me 5 anëtarë.

b) Nënkomisioni i Problemeve të Emigracionit, me 5 anëtarë.

8. Komisioni për Bujqësinë dhe Ushqimin, me 11 anëtarë.

9. Komisioni për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë, me 11 anëtarë.

10. Komisioni për Arsimin, Kulturën, Shkencën, Sportet, me 9 anëtarë.

11. Komisioni i Shëndetësisë e Mbrojtjes së Mjedisit, me 9 anëtarë.

12. Komisioni i Mandateve, Imunitetit dhe të Rregullores, me 7 anëtarë.

- Komisionet kanë kryesi të përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari.

- Nënkomisionet kanë kryetar dhe zëvendëskryetar.

III. Në nenin 10, në rrjeshtin e parë, pas fjalëve "Komisionet e përherëshme..." shtohen fjalët "... dhe nënkomisionet...".

Paragrafi i dytë i nenit 10 të hiqet.

IV. Në nenin 11, paragrafi i parë pas fjalëve: "Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit", të shtohen fjalët "... dhe kryetari e zëvendëskryetari i nënkomisionit" dhe pas fjalëve "... zgjidhen me votim të hapur...", të shtohen fjalët "... përkatësisht nga vetë komisioni e nënkomisioni...".

Po në nenin 11 pas rrjeshtit të fundit të paragrafit të dytë të shtohet fjalia: "Kurse mbledhja

për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të nënkomisionit thirret dhe kryesohet nga kryetari ose zëvendëskryetari i komisionit përkatës".

V. Në nenin 13, në rrjeshtin e tretë pas fjalëve "... komisioneve të përhershme..." të shtohen fjalët "... ose nënkomisioneve..."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.